BULETINI MJEDISOR Nr.9

abonohu në : www.ks.undp.org

NR# 9 (Prill 2013)

NË KËTË NUMËR:

- *"Jeta pa Kosovën A" në sytë e fëmijëve*
- *Riciklimi i mbeturinave, gjeneron vende pune për komunitetin RAE*
- *Fuqizimi i gruas për të drejtën mjedisore*
- *"Treni Ekologjik", për Parkun e Gërmisë*
- *Bjeshkët e Nemuna, Parku i dytë Kombëtarë i Kosovës*
- *Diskutohet për informimin mjedisor dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore*
- *2012 në listën e 10 viteve më të ngrohta në 133 vitet e fundit*

I nderuari lexues,

Në duart tuaja keni numrin e parë të Buletinit Mjedisor për vitin 2013 përkatësisht numrin e nëntë me radhë të tij. Ekipi redaktues i buletinit do të bëjë përpjekje që edhe gjatë këtij viti të ju sjellë lexuesve tema interesante mjedisore nga aktivitetet e grupeve të ndryshme. Mbi të gjitha, do të bëjmë përpjekje që gjatë këtij viti të vendosim në fokus të arriturat që shënohen në sektorin e mbrojtjes së mjedisit duke mos lënë anash as punën dhe angazhimin e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Kosovë. Do të mundohemi që të ruajmë vazhdimësinë e trajtimit të ngjarjeve mjedisore me interes për publikun duke sjellë edhe kalendarin e ngjarjeve mjedisore. Gjithashtu edhe aktivitetet në kuadër të edukimit dhe ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e mjedisit, do të zënë vend në faqet e buletinit dhe në kuadër të kësaj ne edhe më tutje do të mundohemi të japim kontributin tonë duke dhënë këshilla praktike se si mundë të veprohet për të ndihmuar në mbrojtjen e mjedisit. Kuriozitetet mjedisore kanë zgjuar gjithmonë kërshërinë e lexuesve tanë, prandaj informacionet e përmbledhura dhe ngjarjet interesante mjedisore do të mbesin pjesë buletinit tonë.

Duke ju falënderuar të gjithë ata që vazhdojnë të na dërgojmë komente, vërejtje, sugjerime dhe informacione interesante, ne i inkurajojmë që edhe më tutje të vazhdojmë angazhimin e tyre dhe njëherit u bëjmë thirrje të gjithë të interesuarve për bashkëpunim.

Ekipi redaktues

"Jeta pa Kosovën A" në sytë e fëmijëve



"Jeta pa Kosovën A", është tema e një gare në vizatim-pikturim, në të cilën kanë marrë pjesë nxënësit e 6 shkollave fillore nga Komuna e Obiliqit dhe ajo e Fushë-Kosovës, si pjesë e një fushate për ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e opinionit për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja prej termocentraleve. Fushata është iniciuar dhe përkrahur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Nga gjithsejtë 500 punime që kanë marrë pjesë në garë dhe që janë prezantuar edhe në profilin facebook.com/jetapakosovena , 24 prej tyre janë përzgjedhur dhe janë publikuar në një katalog të punimeve. Nga fëmijët është kërkuar që përmes vizatimeve dhe pikturave të shprehin vizionin e tyre për të ardhmen pa Termocentralin Kosova A. Qielli i kaltër, peizazhet e gjelbëruara, parqet me lule e pemë, lumenjtë e pastër, turbinat e erës, fëmijët e lumtur duke u rritur në një mjedis të pastër, janë imazhet që nxënësit do të donin ti shihnin në të ardhmen në vend të tymtarëve që nxjerrin tym, të hirit, të qiellit ngjyrë gri dhe të lumenjve të ndotur. Porosia kryesore që vjen nga imagjinata e fëmijëve është se mbyllja dhe çmontimi i Termocentralit Kosova A do të rezultojë më një mjedis më të pastër dhe me jetë më të shëndetshme për të gjithë. Në fakt, vizioni i fëmijëve për jetën pa Kosovën A, nuk është i parealizueshëm dhe shumë lehtë mundë të bëhet realitet. Mbyllja e Termocentralin Kosova A, është planifikuar të ndodhë në fund të vitit 2017 dhe është vlerësuar se do të kushtojë rreth 28 milion euro.

Qeveria e Kosovës tani më ka themeluar tri grupe punuese për procesin e dekomisionimit të TC Kosova A, që është edhe faza e parë e mbylljes se këtij termocentrali. Mbyllja e TC "Kosova A" është edhe pjesë e obligimeve që Kosova ka marrë në kuadër të Traktatit të Komitetit të Energjisë dhe gjithashtu është e planifikuar edhe në kuadër të Strategjisë së Energjisë 2009-2018 e miratuar në Kuvendin e Kosovës.

INFORMATA TË PËRMBLEDHURA

Në Kosovë numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura është 96.


Në kuadër të këtyre zonave bëjnë pjesë: 11 Rezervate strikte të natyrës, 2 Parqe Kombëtare, 82 Monumente të natyrës, 1 Park i natyrës dhe 2 Peizazhe të mbrojtura.

Sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura është 124712 ha.

Kjo sipërfaqe përfshinë 11.4% të territorit të përgjithshëm të Kosovës.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura në Kosovë, 92.9% u takon Parqeve Kombëtare, 5.4 Monumenteve të Natyrës ndërsa më pak se 1% Rezervateve strikte, Parqeve të Natyrës dhe Peizazheve të Natyrës.

Riciklimi i mbeturinave, gjeneron vende pune për komunitetin RAE



Me mbështetjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) ka filluar projektit "Iniciativa e punës së Qëndrueshme për një të nesërme më të shëndoshë". Pjesë e këtij projekti janë edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Sipas analizës së kryer nga UNOPS dhe OBSH, grumbullimi joformal i mbeturinave dhe klasifikimi i tyre ka ardhur tradicionalisht nga komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Projekti "Iniciativa e punës së Qëndrueshme për një të nesërme më të shëndoshë" ka për qëllim regjistrimin dhe sistemimin e grumbulluesve joformalë të mbeturinave në qendra grumbulluese, me të cilat do të ofrohen shërbime në mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave. Fillimisht është paraparë që të krijohen dy qendra grumbulluese, një në Fushë Kosovë e një në Mitrovicë, të cilat do të mbështesin dhe punësojnë në mënyrë të veçantë grumbulluesit joformalë nga komuniteti REA. Projekte të tilla janë implementuar me sukses në vendet e rajonit dhe besohet që edhe në Kosovë, projekti do të sjellë rezultate si në sektorin e mjedisit dhe ne atë të mirëqenies sociale. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të ndihmojnë në implementimin e projektit gjatë tre viteve të ardhshme me 500.000 euro.

Fuqizimi i gruas për të drejtën mjedisore

Studimet e ndryshme kanë vlerësuar se roli i gruas është i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm në shumë çështje mjedisore sikur janë: ndryshimet klimatike, menaxhimi i mbeturinave, kursimi i ujit të pijes, kursimi i energjisë dhe aspekte tjera mjedisore.

Me qëllim të fuqizimit të rolit të gruas për të drejtën mjedisore, Qendra Regjionale për Mjedis-REC, zyra në Kosovë, ka filluar implementimin e projektit "Fuqizimi i grave në të drejtën mjedisore", aktivitet ky që po mbështetet nga UNDP Kosova përmes "Projektit për avancim të së drejtës gjinore".

Duke iu referuar dy synimeve shumë të rëndësishme të Objektivave të Mileniumit për Zhvillim 2015 të OKB-së: Synimit 3 (Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i gruas) dhe Synimit 7 (Qëndrueshmëria Mjedisore), projekti "Fuqizimi i grave në të drejtën mjedisore", synon të përmirësojë qasjen e grave në të drejtën mjedisore duke ju siguruar informata të duhura për burimet ligjore, avokim dhe stimulim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete përmes kërkesave zyrtare.

Projekti synon po ashtu edhe ngritjen e vetëdijes për shfrytëzimin e mundësive për të reaguar ndaj shkeljeve që i bëhen gruas në lidhje me qasjen në informata mjedisore si dhe të drejtën për pjesëmarrje në vendimmarrje për çështje mjedisore.

Projekti ka filluar së zbatuari në nëntor të vitit 2012 dhe do të përfundojë gjatë muajit prill të vitit 2013.

REC

United Nations Development Programme
UNDP KOSOVO

Si mundë të ndihmojmë në mbrojtjen e mjedisit?



- Veturat ndotin ajrin, rrugëve të shkurtra ec ose shfrytëzoje biçikletën



- Përdor poçe elektrike që kursejnë rrymën. Këto harxhojnë më pak energji dhe kanë jetë më të gjatë se ato të zakonshmet.



KALENDARI MJEDISOR

7 PRILLI
Dita Botërore e Shëndetit

22 PRILLI
Dita e Tokës

31 MAJI
Dita Botërore pa Duhan

5 QERSHORI
Dita Botërore e Mjedisit

8 QERSHORI
Dita Botërore e Oqeaneve

17 QERSHORI
Dita Botërore e luftës kundër shketëtirëzimit dhe thatësirave


"Treni Ekologjik", për Parkun e Gërmisë

Komisioni Evropian do të mbështes Komunën e Prishtinës në implementimin e projektit "Menaxhimi i Qëndrueshëm i Parkut të Gërmisë". Projekt do të kushtojë rreth 510 mijë euro, Komisioni Evropian ka ndarë 360 mijë euro donacion kurse komuna e Prishtinës do të marrë pjesë ne projekt me 150 mijë euro. Përveç tjerash projekti "Menaxhimi i Qëndrueshëm i Parkut të Gërmisë" parasheh rregullimin e shtigjeve për këmbësorë, rregullimin e shtigjeve për çiklistë, rregullimin e vendpushimeve për qytetarë dhe rregullimin e ndriçimit publik në tërë pjesën rekreative të zonës. Ajo çka e bënë të veçantë këtë projekt është ndërtimi i shtegut për "Trenin Ekologjik", i cili përveç që do të jetë një risi për Kosovën, ka për synim që të nxisë qytetarët që të mos përdorin makinat e tyre në hapësirat e parkut. Përndryshe, Parku i Gërmisë është shpallur zonë e mbrojtur e natyrës për shkak të bukurive të rralla natyrore, vlerave burimore dhe estetike natyrore me rëndësi kulturore- arsimore, shkencore dhe turistike- rekreative. Në vitin 1987 Kuvendi Komunal i Prishtinës merr Vendim për mbrojtjen e Kompleksit "Gërmia" në kuadër të kategorisë Park Regjional i Natyrës. Aktualisht Komuna e Prishtinës e menaxhon Parkun e Gërmisë përmes ndërmarrjes "Hortikultura", ndërsa mbikëqyrjen profesionale e bën Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës i cili vepron në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Në vitin 1990, Parku i Gërmisë është evidentuar edhe në listën ndërkombëtare të zonave të



mbrojtura nga Unionit Botëror për Ruajtjen dhe Konservimin e Natyrës (IUCN, 1990 United Nation List of National Parks and Protected Areas). Një pjesë të rëndësishme të sipërfaqes së mbrojtur e përfshinë edhe zona për rekreacion dhe pushim. Kjo zonë është e rrethuar me peizazhet e bukura të pyjeve të dushkut dhe të ahut. Këto vlera atraktive natyrore dhe ajri i pastër i Gërmisë tërheqin vëmendjen e një numri të madh të banorëve të kryeqytetit dhe rrethinës për të kaluar një pjesë të ditës ose edhe fundjavën aty.

Bjeshkët e Nemuna, Parku i dytë Kombëtarë i Kosovës



Me miratimin e ligjit për Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna", Kosovës i është shtuar edhe një zonë e mbrojtur me ligj me status të Parkut Kombëtarë. Është ky Parku Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna" që përfshinë sipërfaqe me rreth 60 mijë ha dhe shtrihet në territorin e komunave: Gjakovë, Junik, Pejë, Deçan dhe Istog.
Territori i shpallur Park Kombëtarë veçohen me vlera të rralla natyrore, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore, me habitate të rëndësishme të llojeve të rralla si dhe karakteristika të pasura hidrologjike, gjeomorfologjike dhe peizazhore që kanë rëndësi shkencore, edukativo-arsimore dhe turistike-rekreative.
Në këtë park, me këtë ligj janë vendosur regjimet mbrojtëse sipas zonës së parë e cila është pjesë e territorit me veçori të jashtëzakonshme natyrore dhe gëzon karakterin e zonës së mbrojtjes strikte, zona e dytë e cila është pjesë e territorit që karakterizohen me ekosisteme dhe vlera tjera të natyrës ku mund të ushtrohen veprimtaritë që nuk janë në kundërshtim më qëllimet e mbrojtjes dhe zona e tretë e cila është pjesë ku lejohet shfrytëzimi i qëndrueshëm e paraparë për ndërtim të objekteve për pushim, rekreacion e turizëm dhe nevojat e banorëve për shfrytëzim të kufizuar të të mirave të natyrës. Me parkun do të administrojë Drejtoria për Administrimin e PK "Bjeshkët e Nemuna" e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, përkatësisht e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Arsyeshmëria profesionale për marrjen në mbrojtje të Parkut Kombëtarë të Bjeshkëve të Nemuna është hartuar në vitin 2003 nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës.

Ky bulletin botohet në bashkëpunim mes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë (MMPH) dhe Programit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë.

Ekipi redaktues:

Afrim Berisha (MMPH), Sami Behrami (MMPH), Shkipe Deda–Gjurgjeali (UNDP) & Burbuqe Dobranja (UNDP).

Për numrin e radhës abonohu në: www.ks.undp.org

Versioni online në: http://www.kosovo.undp.org/?cid=2,176 dhe www.ammk-rks.net

Diskutohet për informimin mjedisor dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës me mbështetje nga Komisionin Evropian përmes Instrumentit të TAIEX (Instrument i Asistencës Teknike për Shkëmbim të Informatave), ka organizuar punëtorinë "Implementimi i Direktivës së Bashkimit Evropian për qasje në informim mjedisor dhe i Konventës së Aarhusit në Kosovë".

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte forcimi i kapaciteteve të institucioneve nacionale mjedisore të Kosovës për të implementuar Direktivën e Bashkimit Evropian për qasje në informim mjedisor dhe Konventën e Aarhusit, për qasje në informim mjedisor, pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes për mjedisin si dhe të drejtën për të ju drejtuar gjykatës për çështje mjedisore.

Përvojën e tyre në implementimin e këtyre dy akteve të rëndësishme ndërkombëtare mjedisore, e kanë prezantuar gjashtë ekspertë nga vende të ndryshme të Bashkimit Evropian, ndërsa në takim kanë marrë pjesë kryesisht përfaqësues nga institucionet mjedisore nacionale mjedisore si dhe përfaqësues nga Organizatat Joqeveritare Mjedisore dhe ekspertë.

Përveç tjera u tha se hartimi dhe miratimi i një marrëveshjeje ose një programi për bashkëpunimin në mes shoqërisë civile dhe institucioneve nacionale mjedisore, për të rritur pjesëmarrjen e publikut dhe OJQ-ve në vendimmarrjen mjedisore, është e domosdoshme sikur që është e nevojshme edhe ngritja e një sistemi efikas të informimit dhe raportimit për mjedisin.



2012 në listën e 10 viteve më të ngrohta në 133 vitet e fundit



Shkencëtaret amerikane thonë se viti 2012 ishte ndër 10 vitet më të ngrohta që bota ka përjetuar që nga viti 1880. Sipas studiuesve te NASA-s, ky ishte viti i nëntë më i ngrohtë. Ata thonë se temperaturat do të kishin qenë edhe më të larte nëse nuk do të kishte ndodhur "La Nina", e cila solli ftohje në disa rajone. Shkencëtarët konstatuan se dioksidi i karbonit ka qene faktori kryesor i rritjes se temperaturës gjatë 50 viteve të fundit. Hulumtimi tregoi se 12 vitet e shekullit 21-të, liston mes 14 viteve më të ngrohta në periudhën 133-vjeçare të mbajtjes së shënimeve.

NASA tha se 2012 ishte viti i 9 -të më i ngrohtë, me temperatura 0.6 grade celsius me të larta se mesatarja bazë e shekullit të 20-të. Sipas studiuesve, shumica e zonave në bote kishin temperatura më të larta se temperatura mesatare e vitit 2012, ndërsa Arktiku përjetoi një rekord të shkrirjes së akullit.

Për me shumë informacion: http://www.bbc.co.uk/news/science-environment-21033083

Si mundë të ndihmojmë në mbrojtjen e mjedisit?



Nëse e ul temperaturën në banesë për një gradë, kursen 6% të energjisë.



Uji është i çmueshëm, mos e lë të rrjedhë pa nevojë.

